

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rritja e qëndrueshmërisë së digës së ujëmbledhësit Kukaj, Pukë” .

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45247210-5 ; 45247200-2; 45247000-0

- Punim ndertim per diga
- Punim ndertim per diga dhe te ngjashme
- punime ndërtimi për diga, kanale, kanale të ujitjes dhe ujësjellës

VLERA E FONDIT LIMIT: 32,439,851 (tridhjetë e dy milion e katerqind e tridhjetë e nenete mije e teteqind e pesedhjetë e nje mije) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia PUKË ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Procedura perzgjedhese e prokurimit qe do te perdoret ne kete tender eshte percaktuar sakte ne urdherin e prokurimit: "Tender i Hapur".

Procedura e prokurimit eshte mbi kufirin e ulet monetar dhe nen kufirin e larte monetare

Në përputhje me nenin 33 të LPP kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

- 528.781.400 (pesëqind e njëzet e tetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind) lekë për kontratat e punëve publike;
- 13.699.000 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12.000.000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 10.000.000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në Nenet 76, 82 dhe 83 të LPP dhe Nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kërkesat e mesipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet tatimore dhe ato të energjise elektrike sipas përcaktimeve të legjislacionit perkates.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjislacioni në fuqi mesipërcituar, si një mjet garancie për AK në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimi të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (regjistrat tregtarë, sipas nenit 77, pika 1/a dhe 2, të LPP-së) dhe të kete në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023,2024,2025) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit).

Shënim: Akt Ekspertizë e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe Nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në Nenin 29 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji”.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej **50 milionë lekësh;** ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej **100 milionë lekësh;** iii) ka, mesatarisht, **30 të punësuar** gjatë periudhës kontabël”

2.2.2 2.2.2 Kopje të deklaramit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2023, 2024,2025) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet . Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në Nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe në Nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. ku percaktohet se: ” Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedurës është “E Hapur – Punë Publike - ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar – Prokurim publik me mjete elektronike”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të Nenit 43, pika 2, gërma ”a” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: ”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund

të tejkalojë: vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi

Përcaktimi i vlerës së kërkuar të xhiros (jo më e vogël se vlera e kontratës) është brenda marzhit të lejuar që mund të kërkohej. Gjithashtu për të stimuluar të gjithë operatorët e rinj që operojnë në treg si dhe për rritur numrin e konkurrentëve në këto procedure është gjykuar që vlera e xhiros së kërkuar të jete minimalisht sa vlera e parashikuar e kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 43, pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026 për kesten e maturuara sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar).

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Argumentimi. *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), ku në zbatim të legjislacionit në fuqi, Qendra Kombëtare e Biznesit ka funksion të mbajë regjistrin tregtar dhe për qëllim të regjistrimit fiskal, në të cilin përcaktohen dhe vendet e ushtrimit të operatorëve ekonomikë, duke qenë se këto të fundit kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendet që ushtrojnë aktivitetin e tyre atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore*

Kjo kerkese është vendosur me qëllim që AK të ketë mundësinë të shohë nëse OE pjesëmarrës kanë apo jo detyrime ndaj NJ.Q.V, fakt që tregon fleksibilitetin e tyre financiar

Njësia e prokurimit përcaktoi kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart, duke qenë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Përvojë e suksesshme në realizimin e punëve të ngjashme për një objekt të vetëm, me vlerë jo më të vogël se 49 % e vlerës së përllëgoaritur të kontratës që prokurohet, të realizuara gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, të marra së bashku, gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të jetë në një vlerë jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

2.3.1 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese te deklaruar ne organet tatimore .
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese te deklaruar ne organet tatimore .

2.3.2 Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokuren e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.

2.3.3 Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77** të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **c) aftësinë teknike dhe profesionale.** Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Pika 4.Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.”

Në nenin 39 “Kërkesat të veçanta për kontratat për punë publike” pika 5 dhe 8 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “pika 5. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: **a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.** Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore **dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.**

Pika 8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

AK përcaktoi kriteret për punë të ngjashme si më lart duke qënë se këto kritere janë të detyrueshme, janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sipas këtij neni, AK vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacioneve ligjore të zbatimit të punimeve, bazuar në Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b, të paraqesin dhe kontratën e sipërmarrje, aktin e kolaudimit, situacionin përfundimtar, certifikaten e marrjes në dorezim të përkohshëm/përfundimtar si dhe formular vlerësimi për punët e kryera me entet publike, për të patur mundësi të bindet nëse operatori ekonomik zotëron përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës, ku punimet e mëparshme duhet të kenë zëra të konsiderueshme punimesh me zërat e punimeve që po prokurohen, si dhe në rastin kur punimet e mëparshme janë kryer si bashkim operatorësh ekonomikë, nuk jepet informacion mbi përqindjen e anëtarëve në bashkim, në vërtetimet që lëshojnë autoritetet kontraktore dhe në faturat tatimore të shitjes, ku këto të fundit lëshohen nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Meqënëse paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që Autoriteti të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

Gjithashtu është kërkuar:

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: *Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, është kërkuar edhe paraqitja e kontratës së bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE, mbështetur në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, ndër të tjerash përcaktohet se, citojmë:*

*“3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”

Me anë të këtij dokumentacioni autoriteti kontraktor ka mundësi të njihet me vlerën reale të punimeve të realizuara nga ofertuesi/t, mbi bazën e një kontrate të realizuar si BOE.

Referuar natyrës së kontratës për punë publike, AK vlerëson se duhen kërkuar disa prej dokumentacionit ligjor të zbatimit të punimeve, bazuar në ligjin Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe akteve në zbatim të tij, pasi duke qënë se kontrata për punë publike që po prokurohet është në bazë të punimeve me matje, sipas nenit 39 pika 1/a e VKM-së, lind e nevojshme që operatorët ekonomikë pjesëmarrës krahas dokumentacionit të përcaktuar në nenin 39 pika 5/a dhe b të VKM-së, të paraqesin dhe kontratat e sipërmarrjes, situacionet përfundimtarë, si dhe Faturat Tatimore sipas legjislacionit në fuqi, për të vërtetuar faktin, nëse operatori ekonomik pjesëmarrës zotëron eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor është kërkuar edhe miratimi nga ana e autoritetit kontraktor, si nënkontraktor i deklaruar, në respektim të parashikimeve të nenit 89 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Pra, dokumentacioni i kërkuar si më sipër, është kërkuar me qëllim që AK të përlllogarisë vlerën e saktë të kontratave të mëparshme të realizuara nga ofertuesi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2.3.1.

Duke qënë se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, nuk sjell diskriminim dhe/ ose kosto shtesë për operatorët ekonomikë pjesëmarrës, por i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e përvojës së duhur të tyre, duke mundësuar zhvillimin normal dhe në kohë të procedurës së prokurimit, pasi nuk ka nevojë që A.K., të kërkojë informacione shtesë gjatë vlerësimit të ofertave (në rast mungese të informacionit të sipërcituar), njësia e prokurimit gjykon se kërkitimi i dokumentacionit përcaktuar në kushtin e mësipërm është i nevojshëm për vërtetimin e kryerjes së punëve të ngjashme.

*Kriteret e mëposhtme teknike nga pika 2.3 dhe ne fund janë propozuar dhe vendosur nga specialisti i fushës, pjesë e njësisë së prokurimit, sipas përcaktimit të nenit 74, dhe 78 të VKM nr. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik si dhe njoftimit nr. 4916/2 prot, datë 14.07.2022, pika 1, të Agjencisë së Prokurimit Publik “**Mbi organizmin e Procedurave të Prokurimit Publik**”*

2.3.4 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.P-1 A Punime germimi e toke

N.P-6 A Diga dhe tunele hidroteknike

NP-9 B Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime

Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N.S-18 A (Punime topogjeodezike)

OE. duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat për dhënien e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimore".

Operatorët e huaj duhet të barazvlerësojnë (ekuivalentojnë) licencat profesionale që ata kanë lëshuar nga vendi i origjinës, në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrinë kompetente) në Republikën e Shqipërisë. (Rregullore për kriteret dhe procedurat për lëshimin e licencave profesionale për zbatimin, klasifikimin dhe disiplinimin e personave juridikë që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, miratuar nga VKM, Nr. 42, datë 16.01.2008).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Gjithashtu, të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, Ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, Neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë,*

privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane” si dhe VENDIM Nr. 448, datë 31.7.2025 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT , neni 6 qe percakton kushtet dhe kriteret për subjektet zbatuese si me poshte : 1. Çdo subjekt juridik i licencuar ka të drejtë të ushtrojë veprimtari zbatimi, vetëm për kategoritë e punimeve, që ka përcaktuar në licence .

-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
<i>N.P-1 A</i>	<i>Punime germimi e toke</i>	Kjo kategori përfshin zërat e punimeve për rrafshimin dhe sistemimin e skarpatave me krahë në germim toke të butë, transportin e dheut me automjet deri në distancën 5.0 km, si dhe germimin e dheut me ekskavator me zinxhir, me kovë 0.5 m ³ , në kanale me gjerësi mbi 2 m, në prani uji rreth 1 m, në tokë të kategorisë IV, me ngarkim dhe shkarkim në mjet.	A (0- 20 milionë lekë)
<i>N.P-6 A</i>	<i>Diga dhe tunele hidroteknike</i>	Kategoria “Diga dhe tunele hidroteknike” përfshin të gjithë vlerën e punimeve të parashikuara në preventiv për realizimin e objektit, në përputhje me emërtimin dhe funksionin e tij. Në këtë kategori përfshihen të gjithë zërat e punimeve të përcaktuara në preventiv, të cilat lidhen me ndërhyrjet, germimet, sistemimin, transportin e materialeve dhe punimet e tjera të nevojshme për realizimin e objektit sipas projektit dhe preventivit.	A (21 - 50 milionë lekë)
<i>NP-9 B</i>	<i>Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime</i>	Kjo kategori përfshin gabiona me rrjetë teli të zinkuar dhe të mbushura me gurë kave, të destinuara për punime mbrojtëse, stabilizim dhe përforcim të terrenit, mbrojtje të skarpateve, kanaleve dhe brigjeve. Kategoria përfshin gabiona me përmasa 1 × 1 m, 1 × 1 × 1.5 m dhe 1 × 1 × 2 m.	B (0- 20 milionë lekë)

		Rrjeta e telit të zinkuar siguron rezistencë ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike, ndërsa gurët e kave shërbejnë si material mbushës për krijimin e strukturave të qëndrueshme dhe rezistente.	
N.S-18 A	<i>Punime topogjeodezike</i>	Objekti ka punime topogjeodezike, të cilat përfshijnë rilevimin topografik të zonës dhe të objektit, përcaktimin e koordinatave dhe kuotave, piketimin e akseve dhe elementeve të objektit, si dhe kontrollin topografik gjatë zbatimit të punimeve. Këto punime janë të nevojshme për përcaktimin e saktë të pozicionit dhe niveleve të objektit dhe për garantimin e zbatimit të punimeve sipas projektit.	A (0- 20 milionë lekë)

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçense të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit e cila duhet të përmbajë kodin 17.09.04. Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, licencat e mesiperme duhet të disponohen nga nga anetari që do të kryejë shërbimet perkatese)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendim Nr. 538 date 26.05.2009 “Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit (QKL) dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”. si dhe ne permbushje te detyrimeve ligjore qe percakton Ligji 10431 date 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” (te ndryshuar). Ky kriter synon mbrojtjen e mjedisit dhe shendetit nga ndotja dhe demtimi prej mbetjeve te ngurta, nepermjet administrimit mjedisor te tyre ne cdo faze, perfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, perpunimin, magazinimin, asgjесimin, te cilat cojne ne pakesimin e mbetjeve dhe zvogelimin e ndikimeve te tyre te rrezikshme e te demshme. Duke qene se ne preventivin e punimeve jane pasqyruar punime prishje, germimi eshte gjykuar qe subjekti duhet te kete lejen e posacme per veprimtari te tilla si Stacionim transferimi per mbetjet nga prishjet dhe ndertimet, per mbetjet e ngurta urbane dhe magazinim i perkoshem i tyre. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat/lejet profesionale që parashikohen nga legjisllacioni në fuqi për kryerjen e proceseve të punës të parashikuara në preventivin objekt kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të perfshire në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Inxhinier Gjeodet 1 (një)
- Agronom 1 (një)

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë personelin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa përpara lidhjes/nënshkrimit të kontratës operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë për personelin inxhinier të sipërcituar dokumentacion e lart përmendur

Shenim : Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për inxhinieret e mesipërm, emer/mbiemer, atesia , numrin dhe titullin e kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këto kritere i ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6.

Keto kritere i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për tu bindur se OE zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, aftësitë organizative, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Këtu nga AK janë përcaktuar kriteret e nevojshme për personelin e kualifikuar sipas niveleve të ndryshme të kualifikimit dhe profileve të nevojshme mbështetur në tipologjinë e punimeve, si dhe kërkesat për fuqi punëtore referuar përmasave dhe natyrës së kontratës, objekt prokurimi.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar nga AK janë kërkuar disa kategori personeli, të domosdoshëm për të kryer të gjitha shërbimet e nevojshme dhe mbulimin e të gjitha hallkave/etapave të zbatimit të projektit, sipas nivelit të kompetencave profesionale deri në realizimin e plotë të veprës.

Në kërkesat për personelin e kualifikuar janë kërkuar ekspertët inxhinierë të licensuar, sipas profileve të domosdoshme për të mbuluar të gjitha punimet e parashikuara në projekt – zbatimin e parashikuar të relizohet nëpërmjet kësaj kontrate, të cilët duhet të jenë të përfshirë në licensën e shoqërisë.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. **Drejtuesi teknik është përgjegjës** për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Referuar natyrës dhe përmasave të kontratës objekt prokurimi, me qëllim ndërtimin e investimit tejet të rëndësishëm sipas projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, dhe **vërtetimin e aftësisë organizative, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën**, njësia e

prokurimit referuar zërave të punimeve që do të kryhen objekt kontrate, **vlerëson se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të disponojnë stafin e drejtuesve teknik (inxhinierët) me kualifikimet e kërkuara.** Kërkesa specifike për inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të preventivit të punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik), ku më hollësisht parashtrojmë:

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

-Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon punime të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e gërmimit, punimet e kanaleve, punime betonimi etj. Punimet e ndërtimit duhet të përmbushin kushtet teknike të zbatimit. Respektimi i kërkesave për qëndrueshmëri strukturore dhe qëndrueshmëri, përdorimi i materialeve që nuk janë të dëmshëm për jetën dhe shëndetin e përdoruesve të ambienteve dhe saktësia në realizimin e të gjithë elementëve konstruktivë sjellin domosdoshmërinë që çdo element dhe hallkë e zbatimit të këtyre punimeve të ndiqet dhe udhëhiqet nga ekspertë të licensuar të fushës. Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standardet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi. Ndjekja e të gjithë procesit ndërtimor që në fazën e pare, punimet e ngritjes së kantierit, do të ishte e nevojshme që të angazhohesh një inxhinier ndërtimi. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar angazhimi i të paktën një eksperti inxhinier ndërtimi i licesnuar, i cili të jete te përfshirë në licensën e shoqërisë.

Inxhinieri i Ndërtimit është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivit si dhe për sigurimin teknik në proceset e punes. Ky inxhinier ka për qëllim menaxhimin e zbatimit të punimeve ndërtimore, analizimin e projektit pasi kemi të bëjmë me punime ndërtimi apo rikonstruksioni, ndjekjen e ecurisë së punimeve në kantier;

-Ndjekja e procesit ndërtimor për realizimin e strukturave mbajtëse, punimet e përfundimit strukturor në preventivin respektiv në këtë objekt do të ishte e nevojshme që të angazhohesh një inxhinier ndërtimi. Në kriteret e veçanta të kualifikimit është kërkuar angazhimi i të paktën një eksperti **inxhinier ndërtimi**, i cili të jete te përfshirë në licensën e shoqërisë.

-Objekti i parashikuar të rehabilitohet në teresinë e tij është punime hidroteknike, pasi kemi të bëjmë me dige ujembledhës. Për realizimin e këtij projektit hidroteknik, zbatuesi duhet të mbështetet në projektin, relacionin, specifikimet teknike, preventivin dhe grafikun e punimeve hidroteknike. Punimet duhet të realizohen në përputhje me zgjidhjet teknike dhe specifikimet e projektuesit. Për drejtimin teknik të këtyre punimeve është e nevojshme që të angazhohen minimalisht dy inxhinierë hidroteknike të përfshirë në licensën e shoqërisë.

Inxhinieri Hidroteknik është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar zërave hidroteknike, etj.

Punimet për riaftësimin e territorit, si rezultat i dëmeve në mjedis që do të shkaktohen si rezultat i punimeve ndërtimore për zhvillimin e territorit nëpërmjet Ndërtimit të Veprës së Marrjes dhe Zgjatim i Kanalit të Darsisë duhet të drejtohet nga të paktën një inxhinier i licensuar në fushën përkatëse, **inxhinier mjedisi.** Perpos edhe në raportin e Vleresimit të Ndikimit në Mjedis, jepet informacioni i duhur për aktivitetin që është menduar të kryhet në përputhje me kërkesat mjedisore, si dhe për

zhvillimin e aktivitetit që do të jetë në përputhje me kriteret për mbrojtjen e mjedisit pra për zbatimin dhe zhvillimin e aktivitetit nevojitet eksperiencia profesionale e Inxhinierit të Mjedisit. Duke qënë se punimet do të kryhen në mjedis të pasur, lind e domosdoshme disponimi i këtij inxhinieri, pasi mbrojtja e mjedisit gjatë kryerjes së punimeve ka një rëndësi shumë të veçantë.

Ne lidhje me kërkesen e Drejtuesit Teknik inxhinier Mjedisit, AK ka marre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit teknik dhe Specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, Zbatuesi i Punimeve eshte ngarkuar me detyrime te përgjithshme ne kujdesin per mjedisin. Metodot e punës qe duhet te aplikohen nga zbatuesi duhet te synojnë ne minimizimin ose nëse eshte e mundur ne ndalimin e cenimeve ndaj mjedisit. Gjithashtu kerkohet qe te nderrmerren me rigorozitet masa mbrojtese sa here qe te jete e nevojshme per te minimizuar ose per te ndaluar efektin negativ ne mjedis.

Ne lidhje me kërkesen e Drejtuesit Teknik inxhinier Gjeodet, AK ka merre ne konsiderate dhe thekson se referuar raportit teknik dhe specifikimeve teknike te projektit objekt prokurimi dhe kompleksitetit te kontrates, i gjithë pikeimi do te kryhet nga Sipermarresi.

Inxhinier Gjeodet / Topograf është përgjegjës për kontrollin e punimeve të germimeve, pasi do të kryejë azhurnimin topografik dhe pikeimin e objektit si dhe do të ndjekë punimet e zbatimit sipas kuotave të projektit. Gjithashtu pas përfundimit të punimeve do të bëjë edhe azhurnimin faktit (as built); Ky inxhinier është i nevojshem për dhënien në terren të kuotave të nevojshme mbi dhe nën tokësore gjatë zbatimit të punimeve të objektit deri në përfundimin e plotë të tij në përputhje me kuotat e përcaktuara në projektin e zbatimit të objektit.

Duke qënë se objekti i kontratës ka për qëllim Ndertim e qendrushmeris se diges dhe ujembledhesit te Kukajt që shërben drejtpërdrejt për ujitjen e tokës bujqësore,mbjelljen e pemeve dekorative si dhe kujdesjen ndaj tyre per te gjithë periudhen e garancise se punimeve , realizimi i saj kërkon njohuri jo vetëm në fushën e ndërtimit hidroteknik, por edhe në administrimin agronomik të ujitjes, kërkesat hidrike të kulturave bujqësore, funksionimin e rrjetit të shpërndarjes së ujit dhe efektivitetin e skemës së ujitjes. Për këtë arsye, prania e një **inxhinieri agronom** në stafin teknik është e domosdoshme për të garantuar që investimi të përmbushë funksionin për të cilin financohet. Kjo kërkesë lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës dhe është proporcionale me qëllimin e saj, duke garantuar funksionalitetin agronomik të skemës së ujitjes."

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik te punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", pika 2 ku përcaktohet se: "Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit" dhe pika 2: "elementët e licensës" gërma "c" ku citohet se: "Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë".

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me

njëri tjetrin , stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.3.7 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem si dhe të ketë eksperiencë pune minimum.

- i. Libreze pune (perkatëse)
- ii. CV perkatëse
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarime të reme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma a, të Ligjit 9643, dt 20.11.2006 i ndryshuar “Për Prokurimet Publike”

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Vendosja e këtij kriteri mbështetet në VENDIM Nr. 448, datë 31.7.2025 PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERITVKM Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, neni 8 që përcakton se Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dypozitave ligjore në fuqi.

2.3.8 Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

1. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar për 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/Certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").*
2. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar për 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").*
3. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar 1 (një) punonjës i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialeve, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave

Shenim: *Per stafin ekerkuar ne pikat 4.5 operatorët ekonomike duhet të deklarohen në Formularin përmbledhës të vetedeklarimit, emer/mbiemer, profili i punës, numer /date kontrate individuale të punës, numër dhe titull të Diplomës/Certifikatë, si dhe institucioni që ka lëshuar dokumentin.*

Argumentimi 1. AK argumenton se kërkesa për Përgjegjësin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Autoriteti Kontraktor me vendosjen e këtij kriteri ka për qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi, në përputhje me zbatimin e rregullave në kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, sic përcaktohet në Nenin 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“. Kërkesa për disponimin e përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë sipas çertifikimit përkatës shmanget dhe parandalon çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë në kantier dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë e stafit në kantier. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi. Funkcioni i përgjegjësit për sigurinë dhe mbrojtjen në punë ka karakter parandalues dhe mbikëqyrës. Ai përfshin identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve në vendin e punës, hartimin dhe zbatimin e masave parandaluese, monitorimin e respektimit të rregullave të sigurisë, si dhe këshillimin e punëdhënësit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë

Argumentimi 2. Ky kriter është hartuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 8, të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënsi merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë,.....“. Kërkesa për disponimin e ekspertit të ndihmës së parë dhe ndërhyrjes në emergjencë gjatë proceseve të ndërtimit në kantier është i rëndësishëm pasi ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në dhënien e ndihmës së parë në rast aksidentesh në vendin e punës, ul rrezikun e pasojave ndaj jetës dhe shëndetit të punonjësve, në rast aksidenti, në kantier. Në këto kushte, është kusht ligjor vendosja e këtij kriteri pasi shërben si garanci që ofertuesit do të realizojnë punimet në përputhje me standartet ligjore në fuqi

Argumentimi 3 : AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nga preventivi i punimeve rezulton se kontrata përfshin volume të konsiderueshme punimesh rrugore, ndër të cilat shtresa çakëlli, shtresa zhavorri, shtresa stabilizanti, shtresa binderi dhe shtresa asfaltobetonit. Këto zëra përbëjnë elementë kryesorë strukturorë të objektit të kontratës dhe ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, performancën dhe jetëgjatësinë e investimit. Në specifikimet teknike të procedurës janë parashikuar detyrime të qarta për kontrollin e cilësisë së asfaltobetonit dhe betonit, marrjen e mostrave, kryerjen e provave laboratorike, verifikimin e treguesve fizikë dhe mekanikë, si dhe dokumentimin teknik të rezultateve të kontrollit. Në mënyrë të veçantë, specifikimet teknike parashikojnë kontroll të vazhdueshëm të cilësisë së prodhimit të asfaltobetonit dhe betonit, marrje mostrash për analiza laboratorike, kontroll të cilësisë së asfaltobetonit të shtruar dhe betonit të hedhur në vepër, si dhe mbajtjen e akteve teknike ku pasqyrohen të gjitha të dhënat e kontrollit me pamje, matje dhe prova laboratorike. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Kërkesa specifike e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve. Operatori ekonomik duhet të disponojë kapacitete profesionale të mjaftueshme për monitorimin, ndjekjen dhe kontrollin e cilësisë së materialeve gjatë gjithë procesit të zbatimit të kontratës. Në këtë kuptim, disponimi i 1 (një) Specialisti për Testimin e Performancës së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit/Inxhinier Materialeve ose Operatori Ekonomik duhet të paraqesë raporte testimi laboratorike të lëshuara nga laborator të akredituar për kryerjen e testimeve për materialet kryesore të ndërtimit (asfalt, beton), sipas kërkesave të projektit përbën një kërkesë proporcionale dhe të nevojshme për garantimin e cilësisë së punimeve duke marrë në konsideratë natyrën e objektit të prokurimit dhe kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike. Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet te kete fuqi minimale punetore te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, me nje numer prej mesatarisht 40 (dyzet) personave , mesatarisht per te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve” për te pakten tre muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK

Argumentimi: Në përcaktimin e numrit te punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje per 3 (tre) muajt e fundit, te deklaruar nga data e hapjes se ofertave , tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiqet të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim te paktën 165 persona duke përfshire dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM Nr. 216, datë 13.4.2023 “ Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” .Bazuar ne kater elementet e struktures se kostos(material, puntori, makineri, transport).

Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore.

Kete perlllogaritje si nevojë e transparencies ndaj ofertuesve po e paraqesim te detajuar si me poshte:

N R.	KOD I	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSI A	SASI A	ORE PUNE
		1. PUNIME GERMIMI			
1	3.48/a	Rrafshim skarpatesh, me krahe, ne germim toke te bute	m2	1458	379.1
2	3.158 /5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	939.14	244.2
3	3.105 /b	Germim dheu me ekskavator zingjir 0.5 m³, ne kanale gjeresi > 2 m, prani uji ~ 1m, kategoria IV, me shk ne mjet	m3	720.44	42.5
		2. PUNIME SHITESASH			
4	3.183 /a	Shtrese zhavor lumi t=10cm	m2	1458	218.7
5	3.211	Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	1083.5	595.9
6	3.212 /c	Shtrese stabilizant t=15cm	m2	1083.5	151.7
		3. PUNIME BETONI E BETONARMEJE			
7	3.245	Struktura monolite betoni C 25/30	m3	146	2277.6
8	3.245 /1	Struktura te holla monolite betoni C 25/30	m3	281	4383.6
		4. PUNIME HEKUR BETONI			
9	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	12.7283	771.7
10	2.166 /1a	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	ton	36.204	2195
		5. NDERTIMI I VEPRAVE TE ARTIT+KANALIZIME			
11	3.331	Gabiona me rrjete teli te zinguar e gure kave 1x1x1 m	m3	664	3718.4
12	3.332	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x1.5 m	m3	498	2639.4
13	3.333	Gabiona me rrjete teli te zinguar, gure kave 1x1x2 m	m3	664	3386.4
					21,004.2

Nr	Emertimi	Sasia
1	Numri i diteve qe do te punohet	63 dite
2	Numri i punonjesve	40 Punojes

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë” si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së

ofertave. Për stafin e mëposhtëm nuk pranohen më shumë se 2 (kualifikime profesionale/teknike), si më poshtë:

- Teknik ndërtimi 1 (nje)
- Betonues 3 (tre)
- Karpentier 3 (tre)
- Hekurkthyes 3 (tre)
- Gurepunues 5 (pese)

- a) Për stafin teknik, ofertuesi duhet të paraqesë kontratën individuale të punës te vlefshme; dhe dëshmi /certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm;

Stafi i mësipërm duhet të figurojë ne listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave

- b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik pjesemarres si dhe subjektet mbështetes te deklaruar nga operatoret pjesemarres si subjekt mbështetes, duhet të deklarojnë per stafin e tyre te dhenat si me poshte:

-Per punonjesin teknik ndertimi, teknik topograf, duhet te deklarohet emer/mbierner, profili i punes, numer dhe date kontrate individuale të punës, diploma perkatese e shkolles se mesme si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin.

-Per punonjesit e tjere te stafit teknik_duhet te deklarohet emer/mbierner, profili i punes, numer dhe date kontrate individuale të punës, numer dhe titull i kualifikimit per diplomën / dëshminë përkatëse, si dhe institucioni qe ka leshuar dokumentin bazuar ne Ligjin 15/2017.

Argumentim Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, sipas fushave që përfshijnë punimet për zbatimin e projektit.

Këtu përfshihen kërkesat për punonjësit, të cilët janë trajnuar/certifikuar për kryerjen e punimeve të caktuara të zbatimit, pasi kanë kryer me sukses kurse dhe trajnime profesionale për punimet respektive. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh.Nisur nga punimet e parashikuara të zbatimit, në kriteret e veçanta janë kërkuar punëtorët e kualifikuar si vijon:

Teknik ndërtimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

-Për zbatimin e punimeve ndërtimore të tilla si punimet e gërmimit, punimet strukturore, punimet e shtresave, etj është kërkuar 1 (nje) teknik ndërtimi . Prania e nje tekniku është e nevojshem për ndjekjen e realizimin e punimeve të ndertimit, sipas zërave të preventivave të punimeve..

Betonuesi është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve te betonimit ne objekt, sipas zërave te punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

Karpentieri është i nevojshëm për përgatitjen e kallëpeve të betonit dhe skelerive sipas zërave te punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin.

Hekurkthyesi është i nevojshem për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, sipas zërave te punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

Gurepunues është i nevojshem për ndjekjen dhe realizimin e punimeve të punimit të gureve për realizimin e mureve me gabiona, si pjesë integrale e realizimit të zërave të punimeve ndërtimore, në përputhje me projektin dhe preventivin

2.3.11 4.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes si me poshte:

- **4 (katër) manovratorë**, të pajisur me dëshmi/certifikatë të vlefshme të aftësisë profesionale për drejtimin dhe përdorimin e **eskavatorëve për gjërmim dhe ngarkim dherash, të të gjitha llojeve, si dhe fadromave të të gjitha llojeve (me goma, me zinxhirë etj.)**, ku në dokumentacionin përkatës të figurojë kategoria/profesia "Eskavatorist"
- **5 (pesë) manovratorë**, të pajisur me dëshmi/certifikatë të vlefshme të aftësisë profesionale për drejtimin dhe përdorimin e **automjeteve për përdorim të veçantë (APV), autovinçave, autobetonierëve, autopompave të betonit, autobitumatriçeve dhe autosondave**, ku në dokumentacionin përkatës të figurojë kategoria/profesia "Automakinist"
- **4 (katër) manovratorë**, të pajisur me dëshmi/certifikatë të vlefshme të aftësisë profesionale për drejtimin dhe përdorimin e buldozerëve për gjërmim, shtyrje, nivelim dhe ngjeshje të dherave; rulave; makinerive për shpim toke; të gjitha llojeve të traktorëve me thikë (ruspë) ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues; rulave vibrues; shtruesve të asfaltobetonit; skreperëve; grejderëve dhe niveluesve vetëlëvizës; si dhe të gjitha llojeve të traktorëve me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj., ku në patentat/dokumentet përkatëse të figurojë kategoria/profesia "**Buldozerist**"

Për punonjesit e mesiperm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës të vlefshme;
 - dëshmitë e aftësisë profesionale/patentat e manovrimi të leshuar nga DPSHTRR duhet të jenë sipas modaliteteve të urdhërit Nr. 200, datë 16.5.2019 (*Në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë*).
- a) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për punonjesit e mesiperm emrin/mbiemrin, profilin e punës numrin dhe datën e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmitë së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerisë së saj.
- b) Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe buldozeriste janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojnë emrin/mbiemrin, profilin e punës, numrin dhe datën e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmitë së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmerisë së saj.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Automakinist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Buldozerist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Eskavatorist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në bazë të analizës teknike.

Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmime të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë :

- a) eskavator gjurmimi e ngarkimi dherash : të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **Eskavatorist**;
- b) buldozer gjurmimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke : të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj., manovratorëve u jepet dëshmi për **Buldozerist**;
- c) automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti : autovinça, autobetonierë, autopompa betoni, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **Automakinist**;

2.3.12 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- a. Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/CEI/UNI 9001:2015 ose ekuivalente.
- b. Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 14001-2026 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/CEI/UNI 14001-2026 ose ekuivalente.
- c. Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit SSH/DIN/EN/CEI/UNI ISO 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar SSH/DIN/EN/CEI/UNI 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën SSH/DIN/EN/CEI/UNI 45001-2018 ose certifikatën për standardin e përditësuar SSH/DIN/EN/CEI/UNI 45001-2023 ose ekuivalente.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, nëpërputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen

ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 - Që një subjekt të jetë i pajisur me certifikatën ISO 9001, do të thotë se ky subjekt ka plotësuar kërkesat e këtij standardi mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”. ISO 9001:2008 specifikon kërkesat për një sistem cilësor të menaxhimit të cilësisë, kur një organizatë:

- duhet të dëshmojë kapacitetin për të siguruar vazhdimisht produktin që kënaq klientin dhe kërkesat statutores dhe normative të aplikueshme.
- synon të përmirësojë kënaqjen e klientit, nëpërmjet aplikimit të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit dhe garancisë të konformitetit me klientin dhe kërkesat statutores dhe normative të aplikueshme.

Me anë të kërkesës për paraqitjen e kësaj certifikate të 2008 ose të përditësuar, AK kërkon të vërtetojë se Oe ka kapacitetin për të garantuar konformitetin me kërkesat cilësore të tij.

ISO 45001 : 2023 - Rreziqet që lidhen me punën në kantier janë të shumta dhe janë shtjelluar në kriteret e mësipërme, si dhe në specifikimet teknike të projektit të zbatimit. Për këtë arsye, Ak duhet të sigurohet se Oe zotëron kapacitetet për menaxhimin, kontrollin dhe parandalimin risqeve për sigurinë e jetës dhe shëndetit gjatë procesit të punës

Certifikata **ISO 45001 : 2018** dëshmon se subjekti plotëson kërkesat e paraqitura nga ky standard për identifikimin, kontrollin dhe zvogëlimin e risqeve, të lidhura me shëndetin dhe sigurinë në vendin e punës.

ISO 14001:2026 - Sikurse vëren edhe VNM e pregatitur nga projektuesi, zbatuesi i punimeve duhet të marrë parasysh një sërë masash për zbutjen e efekteve negative në mjedis, si rezultat i zbatimit të punimeve për përmbushjen e kësaj kontrate. Të gjitha punimet e parashikuara në këtë procedurë duhet të kryhen në përputhje me specifikimet dhe dokumentacionin teknik të pregatitur nga projektuesi, duke respektuar legjislacionin shqiptar për mbrojtjen e mjedisit.

Nga sa më sipër AK ka kërkuar që OE të paraqesë certifikatën ISO 14001:2015 (ose të përditësuar) për të dëshmuar kapacitetin për të kryer punimet në përputhje me rekomandimet e VNM, në konformitet me legjislacionin mjedisor në fuqi dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare të menaxhimit mjedisor.

2.3.13 Operatori Ekonomik duhet të disponojë:

1. Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Furnizimi, per Fabrike prodhimi i inerteve te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.Furnizusi te kete status aktiv ne QKB. (Në

rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit)

2. Ne Pronesi / Kontrate Qeraje/ Kontrate Furnizimi, per Fabrike prodhimi i betoni te pajisura me (Leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Furnizuesi te kete status aktiv ne QKB. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit)
3. Kontrate furnizimi nga prodhuesi per hekur ose nga distributori e shoqeruar me autorizim prodhuesi, pajisur me ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise) e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Certifikata nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN 10080 :2005, SSH EN - ASTM A 510, SSH EN - ASTM A 615, dhe SSH EN DIN 488-2 per cilesine e hekurit.
4. Kontrate furinzimi per gur kave gurorje nga prodhuesi, ose nga distributori e shoqeruar me autorizim prodhuesi, e pajisur me leje mjedisore IV.1.B.2 “Leje minerare shfrytezimi per mineralin gur ranor pllakor”
5. Kontrate furnizimi për gabiona me rrjetë teli të zinkuar, të lidhur me prodhuesin ose, në rast se furnizimi realizohet nëpërmjet një distributori të autorizuar, me distributorin përkatës. Në rast se kontrata e furnizimit është lidhur me një prodhues shqiptar, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që provon se prodhuesi ushtron në mënyrë të ligjshme aktivitetin përkatës, përfshirë Lejen Mjedisore të vlefshme, sipas aktivitetit të ushtruar, ku aktiviteti për prodhimin e produkteve të tilla mbulohet nga kodet përkatëse, konkretisht: Kodi III.1.A – Thurje teli gabion; dhe Kodi III.1.B – Veshje e telave. Në rast se kontrata e furnizimit është lidhur me një distributor, duhet të paraqitet autorizimi i prodhuesit, nëpërmjet të cilit provohet e drejta e distributorit për të tregtuar dhe furnizuar produktet objekt të kontratës, si dhe dokumentacioni që provon lidhjen ndërmjet distributorit dhe prodhuesit.

Në rastin e prodhuesve vendas, Leja Mjedisore duhet të jetë e vlefshme në momentin e paraqitjes së ofertës dhe të përfshijë aktivitetin përkatës të prodhimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për lejet dhe autorizimet mjedisore.

Dokumentacioni i paraqitur duhet të jetë i vlefshëm dhe të mundësojë verifikimin e origjinës, prodhuesit, të drejtës së furnizimit dhe përputhshmërisë ligjore të aktivitetit të prodhuesit me objektin e furnizimit.

6. Kontrate Shërbimi me nje laborator testimi të materialeve kryesore të ndertimit beton, hekur, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombetar ose nderkombetar sipas standarteve SSH EN SSH EN 12350-2:2019 , SSH EN 12504-2:2021 , SSH EN ISO 6892 – 1:2019, SSH EN 12390-8:2019, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, dokumentat e mësipërme duhet ti paraqesë të pakten njeri nga anëtarët e grupit)

Kontratat e mesiperme duhet të jene me objektin e prokurimit dhe te përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Ne baze te nenit 77 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe piken 8, te nenit 40, te VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te

prokurimit publik", me ane te ketij kriteri AK gjykon se disponimi ne pronesi / me qera apo me kontrata furnizimi i ketyre fabrikave eshte nje dokument i rendesishem, pasi pervec se tregon origjinen e mallrave qe kerkohen ne procedure, garanton se ofertuesi eshte i garantuar per ofrirmen tek Autoriteti Kontraktor te ketyre mallrave qe do te perdoren ne punimet e planifikuara. Kjo garanci lidhet njekohesisht edhe me treguesit cilesore te mallrave objekt prokurimi te cilat kerkohen qe te jene prodhuar ne perputhje me standardet dhe cilesite e kerkuara ne DST. Ky kriter eshte ne perpjestim me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejtperdrejte me aftesite organizative, reputacionin dhe besueshrnerine e OE ofertues per aftesite teknike. Kjo kerkese i sherben autoritetit kontraktor per njohjen e mundesise se OE per permbushjen me sukses te kontrates pasi sasia e produkteve qe do te perdoren eshte e konsiderueshme.

2.3.14 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbi 10 -15 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamioncine me kapacitet 3.5 - 5 ton	3 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinc kapacitet mbajtes 3.5 - 7 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinç	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir me kove 1m3	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir me hapje krahu mbi $\geq$ 25 m	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me zinxhir me hapje krahu mbi 18 m	1 copë	Pronësi ose me qera
Bobcat/Minifadrom MT (mjet teknologjik me targa)	2 copë	Pronësi ose me qera
Dumper me goma (mjet vetëshkarkues), me kapacitet mbajtës nga 1 deri në 4 ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Rul vibrues me dhëmbëza dhe me cilindra gome, me kapacitet pune mbi 19 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Rul vibrues me cilindra gome, me kapacitet pune mbi 19 ton	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetonierë kantieri me kapacitet 2 – 3 m ³ , mjet teknologjik me targa	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni	3 copë	Pronësi ose me qera
Pajisje per hekurkthyes (tranxhe,elektrobango)	1 copë	Pronësi ose me qera
Well Point per sisteme dranazhnimi	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 40 copë

- Jelek pune minimumi 40 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 25 copë
- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.
- e. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qartë dhe të dallueshme për secilin mjet të deklaruar, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- f. Për mjetet që sipas percaktimeve ligjore të qarkullimit rrugor nevojitet targa, leje qarkullimi...etj. Operatori ekonomik duhet të deklarojë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubriken përkatëse të dhënat për mjetet e kërkuara në shtojcën 8.
- g. Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përkrahura, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi.
- h. Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë, me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- i. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira / kontrate furniziki janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e aseteve të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e

kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Përshkrimi i makinerive dhe pajisjeve

Kamionët me kapacitet mbi 10–15 ton, 3 copë, do të përdoren kryesisht për transportin e dheut të gërmuar, materialeve të inerteve, zhavorrit të lumit, çakëllit të mbeturinave të karrierës dhe stabilizantit nga vendet e furnizimit deri në kantier, si dhe për largimin e materialeve të tepërta të gërmimit. Këta kamionë do të angazhohen edhe për transportin e gurëve të karrierës që do të përdoren në ndërtimin dhe mbushjen e strukturave me gabiona. Kapaciteti i tyre do të mundësojë realizimin e transportit të sasive të konsiderueshme të materialeve brenda afateve të përcaktuara të punimeve.

Kamionçinat me kapacitet 3.5–5 ton, 3 copë, do të përdoren për transportin e materialeve dhe pajisjeve në brendësi dhe ndërmjet fronteve të punës, veçanërisht për materialet që kërkojnë transport në sasi më të vogla, për furnizimin e zonave të punimeve me mjete ndihmëse, materiale për gabionat, vegla dhe pajisje të ndryshme.

Kamioni me vinç me kapacitet mbajtës 3.5–7 ton, 1 copë, do të përdoret për transportin dhe manipulimin e materialeve që kërkojnë ngarkim dhe shkarkim me ngritje mekanike. Në veçanti do të shërbejë për transportin dhe pozicionimin e elementeve, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për ndërtimin e veprave të artit, kanalizimeve dhe strukturave me gabiona.

Autovinçi, 1 copë, do të përdoret për ngritjen, zhvendosjen dhe pozicionimin e materialeve dhe elementeve të rënda në zonat ku realizohen veprat e artit dhe strukturat mbështetëse. Ai do të përdoret sipas nevojës për manipulimin e materialeve dhe pajisjeve që nuk mund të pozicionohen në mënyrë manuale.

Eskavatorët me zinxhir me kovë 1 m³, 2 copë, do të jenë makineritë kryesore për realizimin e punimeve të gërmimit. Do të përdoren për gërmimin e dheut në kanale me gjerësi mbi 2 m, në prani të ujit rreth 1 m dhe në tokë të kategorisë IV, si dhe për ngarkimin e materialit të gërmuar në automjete. Eskavatorët do të përdoren gjithashtu për hapjen dhe sistemimin e zonave ku do të ndërtohen kanalizimet, veprat e artit dhe strukturat me gabiona.

Eskavatori me zinxhir me hapje krahu mbi 25 m, 1 copë, do të përdoret në zonat ku kërkohet shtrirje e madhe e krahut të punës dhe ku aksesit i drejtpërdrejtë i makinerisë është i kufizuar. Do të shërbejë për punime gërmimi, sistemimi dhe formimi të skarpatave, si dhe për punime në zona pranë kanaleve, veprave të artit dhe strukturave të mbrojtjes.

Eskavatori me zinxhir me hapje krahu mbi 18 m, 1 copë, do të përdoret për gërmime dhe sistemime në zona ku kërkohet shtrirje e zgjatur e krahut të makinerisë. Përdorimi i tij do të jetë veçanërisht i përshtatshëm për punime pranë kanaleve dhe skarpatave, për sistemimin e materialit të gërmuar dhe për përgatitjen e terrenit për ndërtimin e veprave të artit dhe gabionave.

Bobcat/Minifadrom MT, 2 copë, do të përdoren për punime ndihmëse të kantierit, përhapjen dhe sistemimin e materialeve, ngarkimin e materialeve në distanca të shkurtra, pastrimin e zonave të punës dhe nivelimin e sipërfaqeve. Do të përdoren gjithashtu për shpërndarjen dhe manipulimin e materialeve të shtresave, si zhavorr lumi, çakëll, stabilizant dhe gurë për mbushjen e gabionave.

Dumperët me goma me kapacitet 1–4 ton, 2 copë, do të përdoren për transportin e dheut të gërmuar dhe materialeve të ndryshme brenda kantierit, veçanërisht në zonat ku distancat e transportit janë të

shkurtra dhe terreni është i vështirë për qarkullimin e kamionëve. Do të përdoren edhe për transportin e inerteve dhe gurëve të nevojshëm për ndërtimin e gabionave.

Ruli vibrues me dhëmbëza dhe cilindra gome, me kapacitet pune mbi 19 ton, 1 copë, do të përdoret për ngjeshjen e shtresave të tokës dhe materialeve granulare pas përhapjes së tyre. Ai do të angazhohet kryesisht në ngjeshjen e shtresës së çakëllit të mbeturinave të karrierës me trashësi 20 cm dhe të shtresës së stabilizantit me trashësi 15 cm, duke siguruar densitetin dhe qëndrueshmërinë e kërkuar.

Ruli vibrues me cilindra gome, me kapacitet pune mbi 19 ton, 1 copë, do të përdoret për përfundimin dhe ngjeshjen uniforme të shtresave të ndërtuara, veçanërisht të shtresave të stabilizantit dhe materialeve të tjera granulare. Përdorimi i tij do të sigurojë një sipërfaqe të qëndrueshme, të rrafshët dhe me ngjeshje të njëtrajtshme.

Autobetonierët e kantierit me kapacitet 2–3 m³, 3 copë, do të përdoren për përgatitjen, përzierjen dhe transportin e betonit në brendësi të kantierit. Ato do të furnizojnë frontet e betonimit për realizimin e strukturave monolite të betonit C25/30 dhe strukturave të holla monolite, si dhe për betonimet që lidhen me veprat e artit dhe kanalizimet.

Autobetonierja, 1 copë, do të përdoret për transportin e betonit të gatshëm nga pika e prodhimit deri në zonat e betonimit, duke siguruar furnizim të vazhdueshëm dhe ruajtjen e homogjenitetit të betonit gjatë transportit. Ajo do të përdoret kryesisht për strukturat monolite të betonit C25/30 dhe elementet e tjera prej betoni të parashikuara në projekt.

Autopompa e betonit, 1 copë, do të përdoret për pompimin dhe vendosjen e betonit C25/30 në strukturat monolite dhe strukturat e holla monolite, veçanërisht në elemente ku betonimi direkt nga autobetonierja është i vështirë. Përdorimi i autopompës do të mundësojë realizimin e betonimeve në mënyrë të kontrolluar dhe të vazhdueshme.

Vibratorët e betonit, 3 copë, do të përdoren gjatë betonimit të strukturave monolite dhe strukturave të holla prej betoni C25/30. Ato do të shërbejnë për ngjeshjen e betonit të freskët, eliminimin e boshllëqeve të ajrit dhe sigurimin e një mase betoni kompakte, homogjene dhe me cilësi të përshtatshme.

Pajisjet për hekurkthyes, tranxhe dhe elektrobango, 1 komplet, do të përdoren për përpunimin e hekurit të betonit periodik. Pajisjet do të shërbejnë për prerjen, përkuljen dhe formësimin e shufrave të çelikut Ø6–10 mm dhe Ø>12 mm, sipas diametrave, formave dhe dimensioneve të përcaktuara në projekt, duke përgatitur armaturën për strukturat e betonarmeve.

Pajisja Well Point për sistemet e drenazhimit, 1 komplet, do të përdoret për uljen dhe kontrollin e nivelit të ujërave nëntokësore gjatë punimeve të gërmimit. Duke qenë se punimet parashikojnë gërmime në kanale me prani uji rreth 1 m, sistemi Well Point do të ndihmojë në mbajtjen e zonës së gërmimit të drenazhuar dhe në krijimin e kushteve të përshtatshme për realizimin e kanalizimeve, themeleve, veprave të artit dhe strukturave prej betoni.

Në tërësi, makineritë dhe pajisjet e mësipërme do të mundësojnë realizimin e plotë të ciklit të punimeve, duke filluar nga gërmimi, ngarkimi dhe transporti i dheut, rrafshimi dhe sistemimi i skarpave, përgatitja dhe ngjeshja e shtresave të zhavorrit, çakëllit dhe stabilizantit, deri te realizimi i strukturave prej betoni dhe betonarmeje, përpunimi dhe vendosja e armaturës, ndërtimi i gabionave dhe realizimi i punimeve të kanalizimeve dhe veprave të artit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoritetit Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/UNI/EN/CEI/ISO.

Shënim:

Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit kontraktor. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose te kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbeshetese per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë formularin e ofertës, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 1, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Gjithashtu Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojnë edhe preventivin e punimeve i cili është vënë në dispozicion nga autoriteti kontraktor, pjesë e këtyre dokumenteve të tenderit.

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, sjellim ne vemendje se:

- Autoriteti Kontraktor do te beje verifikimin e dokumentacionit ne perputhje me vetedeklarimet e bera në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit te dorezuar perben kusht s’kualifikimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për punët objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasitë e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, janë hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës për ndërtimet civile dhe infrastrukurore dhe kanë për qëllim të sigurojnë cilësi të qëndrueshme, funksionalitet afatgjatë dhe siguri teknike të punimeve të parashikuara. Për shkak të veçorive të terrenit dhe kushteve klimatike të zonës, janë përfshirë elementë të detajuar. Këto specifikime janë proporcionale me objektin e kontratës, të zbatueshme në praktikë dhe janë hartuar me kujdes për të parandaluar keqzbatimin teknik, për të garantuar jetëgjatësinë e rrugës dhe për të krijuar kushte të sigurta qarkullimi për banorët e zonës.

Sipas specifikimeve bashkëngjitur të hartuar, vendosur dhe përllogaritur nga struktura të posaçme të specializuara, e konkretisht nga: “Grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit”, mbështetur në Vendimet të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Specifikime teknike, preventivi, afati dhe kriteret kualifikuese u pasqyruan në dokumentet e tenderit, bashkëlidhur.